



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2019” me RTSH dhe QKK(*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Thoma Gëllçi- Drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Kristaq Traja- Kryetar i Këshillit Drejtues i RTSH-së,

Etleva Kadzadej - drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike në RTSH,

Pandi Madhi - kryetar i Bordit të Administrimit të RTSH-së,

Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Tashmë është bërë zakon që kur fillon diskutimi për projektbuxhetin, në komision thërrasim institucionet e varësisë që të diskutojnë me ne, nëse kanë nevojë për shtesa, për të treguar mënyrën apo për mënyrat për të realizuar detyrën, brenda një buxheti që u është alokuar atyre paraprakisht nga ministria përgjegjëse, Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Por para se të fillojmë mbledhjen, dua t'ia jap fjalën kolegut Ylli, për të thënë nëse kemi kuorumin apo jo.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë, ne mund ta vazhdojmë mbledhjen. Unë do ta përsëris në çdo mbledhje komisioni se ndiej keqardhjen për opozitën, sepse gjëja më e rëndësishme për një vend është buxheti. Në vend që të vijë këtu dhe të debatojmë, ajo vazhdon bojkotin. Ne do të vazhdojmë punën tonë, kështu që do të vazhdojmë seancat dëgjimore me institucionet shtetërore.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Dua të falënderoj të dyja institucionet që kanë sjellë paraprakisht një dokument të shkruar për nevojat dhe aktivitetet që keni parashikuar për vitin 2019. Por para se të fillojmë të bëjmë disa pyetje, do të dëshiroja që secili nga institucionet të bënte shpjegimin e tij.

Urdhëroni, zoti Gëllçi!

Thoma Gëllçi – Faleminderit!

Ashtu siç e keni përpara në dokumentet që ju kemi paraqitur, nga ana e buxhetit të shtetit janë akorduar, në përputhje me ligjin, financime buxhetorë për shërbim për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimin në gjuhë të huaj, për prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare, për orkestrën simfonike të Radiotelevizionit dhe të Kinematografisë, për projekte teknike për futjen e teknologjive të reja.

Me keqardhje në materialin tonë themi se parashikimet e Ministrisë së Financave për financimin buxhetor të Radiotelevizionit Shqiptar janë krejtësisht të pamjaftueshme për të realizuar misionin që ka transmetuesi publik dhe nuk janë në përputhje me ligjin. Për shembull, për shërbimin për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimin në gjuhë të huaj janë parashikuar 220 milionë lekë, kur, në fakt, shpenzimet e Radiotelevizionit Shqiptar për transmetimin për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimin në gjuhë të huaja janë shumë më të mëdha. Tashmë dihet që Radiotelevizioni Shqiptar nuk prodhon vetëm një emision radiofonik prej 4 orësh, që ishte në Radio Tirana me valë të shkurta për bashkatdhetarët, por transmeton 24 orë një program radio dhe 24 orë një program televiziv, që është kanali 3, dhe mund të quhet e

pamundur që të realizohet misioni me të njëjtin financim buxhetor, që është dhënë që kur ishte parashikuar që të jepeshin vetëm 4 orë në ditë, vetëm lajme në radio me valë të shkurtra për bashkatdhetarët. Kështu që ne kërkojmë për shërbimin për shqiptarët jashtë kufirit dhe shërbimin në gjuhë të huaj një shtesë prej 100 milionë lekësh. Këtë kërkesë e kemi argumentuar në faqet që ju kemi shkruar.

Radiotelevizioni Shqiptar tashmë ka arritur të krijojë një sistem modern të transmetimit, që siguron transmetimin e 2 programeve HD dhe 4 programeve SD, si dhe 4 programeve radio në standardin DBS2. Këto investime janë bërë me shumë mund nga Radiotelevizioni Shqiptar, duke shkruar nga një kanal i vetëm, me një format të vjetër, me një figurë shumë të dobët, në 6 kanale që transmetohen për bashkatdhetarët dhe 4 kanale radioje për vitin 2018.

Gjithashtu, ashtu siç e dini, për të arritur objektivin që të jemi të pranishëm në çdo pikë të globit, në çdo platformë dhe në çdo ekran, RTSH-ja ka investuar me fondet e saj në ndërtimin e një platforme *Over the Top Television*, që është televizioni dhe radioja nëpërmjet internetit. Ne i kemi mbyllur transmetimet e shkurtra, ku harxhoheshin para kot dhe krijuam një platformë, në bazë të zhvillimeve të reja teknologjike në Mobile TV dhe në Smart TV; këtë lloj televizioni të avancuar e kemi quajtur “RTSH tani”.

Sot në sistemin e transmetimit *Over the Top Television* TVSH-ja ka rreth 250 mijë përdorues, është rreth 10% e popullsisë së Shqipërisë dhe është një shifër për t’u marrë në konsideratë, që shtohet çdo ditë. Nëpërmjet kësaj platforme RTSH-ja u ofron shqiptarëve kudo në botë të ndjekin të gjitha kanalet TV dhe 5 kanale radio, gjithashtu do të shtohen edhe kanalet e radiove lokale që kemi. Shpenzimet shtesë për këtë program llogariten në vlerën 60 milionë lekë dhe ne për këtë gjë kërkojmë shtesë.

Vazhdimisht në financimin buxhetor është dhënë një shumë e caktuar, që e kemi edhe këtu, 65 milionë lekë për projekte filmike dhe artistike me rëndësi mbarëkombëtare. Radiotelevizioni Shqiptar është kufizuar vetëm në financimin e festivalit “Eurosong” dhe nja dy të tjera; nuk kemi as prodhime filmash, as prodhime serialesh me rëndësi kombëtare. Në qoftë se ne duhet të fillojmë prodhimin dhe bashkëprodhimin e serialeve dhe dramave, që të prekin problemet e mprehta të shoqërisë shqiptare sot dhe subjekteve të ndryshme, qoftë edhe për luftën kundër krimit, drogës dhe edukimit nëpërmjet ligjit apo probleme të tjera sociale të jetës së popullit Shqiptar, atëherë buxheti i shtetit e ka detyrim që të financojë këto lloj programesh, pra financimin e telenovelave e të tjera, si dhe programeve radiofonike, radio dramatizimet, ne kërkojmë një financim shtesë nga këto të parashikuar prej 50 milionë lekësh.

Pika e tretë e detyrimit buxhetor është orkestra simfonike e Radiotelevizionit Shqiptar. Për orkestrën simfonike gjithmonë buxheti i shtetit ka dhënë një shumë të caktuar lekësh, më duket rreth 60 milionë lekë, e cila nuk përballon rrogat, megjithëse, po jua them, rrogat e orkestrantëve të Radiotelevizionit Shqiptar janë më të ulëta se rrogat e orkestrantëve të së njëjtës orkestër simfonike të Teatrit të Operës dhe Baletit. Pra, kjo shumë nuk përballon dot rrogat, përballon rreth 70% të rrogave dhe sigurimeve shoqërore, dhe as që bëhet fjalë që të jetë financuar plotësisht kjo shumë ndonjëherë, pale më pas të kemi studio incizimi në sallë, në ambiente të mbyllura apo në sallë direkt në transmetim, që kjo orkestër, që është e destinuar të luajë muzikën shqiptare, ta propagandojë muzikën shqiptare, t'i shërbejë veprimtarisë së Televizionit por jo vetëm, sepse quhet edhe e Kinematografisë, mund të incizojë vepra të kinematografisë. Prandaj ne kërkojmë që shpenzimet për orkestrën të rriten, domethënë financimi buxhetor të rritet, në vlerën 35 milionë lekë për këtë vit, për të rinovuar akustikën e sallës dhe të teknologjisë dhe për të blerë instrumentet me një vlerë prej 15 milionë lekësh, ndërsa pjesa tjetër të kompensojë pagat dhe sigurimet shoqërore, që janë të detyruara të paguhen nga buxheti i shtetit, dhe aty nuk ka pse të vendoset një shifër arbitrare. Duhet të paguhen, sepse, sipas ligjit, është detyrim që buxheti i shtetit të financojë orkestrën simfonike.

Në zërin e projekteve teknike dhe futjen e teknologjive të reja, Ministria e Financave ka parashikuar një financim prej 250 milionë lekësh. Po ju them se ky 250 milionë lekë është vetëm kontrata e SLA-së, pra e shërbimit, dhe është tallje që të thuash me këtë po financon ndonjë projekt të zhvillimit të teknologjisë në RTSH. Kontrata e SLA-së është kontrata e shërbimit me kompaninë gjermane, që buxheti i shtetit e ka marrë përsipër ta financojë, sepse RTSH-ja nuk ka asnjë mundësi praktike që ta financojë këtë gjë pa ndihmën e buxhetit të shtetit apo pa bërë veprime të tjera. Kështu që, kjo shumë është vetëm për këtë gjë. Në qoftë se buxheti i shtetit dhe Ministria e Financave e kanë seriozisht kur përmendin projektet teknike për futjen e teknologjive të reja, vazhdimisht e kam theksuar se për 27 vjet me radhë teknologjia në Radiotelevizionin Shqiptar është lënë pas dorë, asnjë lloj investimi, është për t'i qarë hallin, ka mbetur shumë pas teknologjive të reja të transmetimit. Ashtu siç jua kam shpjeguar edhe në takime të tjera, ne kemi bërë përpjekje për rinovimin e teknologjisë së prodhimit, duke u rënë më qafë programeve, duke mos financuar dot programe, duke mos bërë detyrën, për të cilën qytetarët shqiptarë paguajnë taksat, duke mos bërë lajmet e duhura, duke mos pasur asnjë korrespondent në rrethe, duke mos pasur asnjë korrespondent në Maqedoni dhe Kosovë, duke mos pasur asnjë korrespondent në Bruksel, sepse të gjitha paratë që mbeten dhe financohen nga taksat për këtë qëllim të qytetarëve, harxhon për pagesën e sistemit të digjitalizimit apo për

kontratën e SLA-së dhe nuk ka asnjë qindarkë për investime serioze dhe teknologjike në RTSH. Ne për këtë kërkojmë një shtesë serioze prej 305 milionë lekësh. Pse e duam këtë?!

Së pari, për mirëmbajtjen e sistemit të digjitalizimit kërkohet një shtesë prej 50 milionë lekësh. Në projektbuxhetin e paraqitur vlera vjetore prej 250 milionë lekësh nuk e përmbush detyrimin në vit që ne paguajmë, 2,2 milionë euro.

Së dyti, gjithmonë e kam bërë të qartë se në Radiotelevizionin Shqiptar ndodhet një pasuri kombëtare në rrezik, i cili është arkivi Radiotelevizionit Shqiptar. Prej shumë kohësh flitet për arkivin, flitet me termat që ai është një pasuri kombëtare, por çfarë po bëhet me këtë pasuri kombëtare?! Deri tani kjo është lënë në gjendjen e degradimit dhe jemi në fazën kur mund ta humbasim përgjithmonë. Me ato fonde të vogla dhe të pakta që kemi për këtë qëllim, ne po bëjmë përpjekje që ta ruajmë që të mos shkatërrohet, por vetëm kaq, jo për të qenë vërtetë pasuri kombëtare. Prandaj kërkojmë një shtesë në financim të veçantë për arkivin. Këtë shtesë e kërkojmë të ndarë: projekti i parë është rikonstruksioni i ambienteve të arkivës së zërit, dhe nuk përfshihet për videon, që ka një vlerë, sipas projektit të bërë nga Radiotelevizioni Shqiptar, rreth 40 milionë lekë. Nëpërmjet këtij projekti synohet rikonstruksioni i fondit arkivor, fonoteka e Radio Tiranës. Projekti përfshin pjesën ndërtimore, si dhe sistemet e ruajtjes nga lagështia, temperatura, mbrojtja nga zjarri e të tjera.

Projekti i dytë është krijimi, sepse nuk ekzistojnë, i ambienteve të përshtatshme, sipas standardeve teknike për procesin e digjitalizimit të materialeve të arkivës. Digjitalizimi i arkivës kalon në disa hallka, nga kontrolli i shiritit, larja e shiritit, ngjitja, pastrimi, indeksimi dhe digjitalizimi. Këto procese kërkojnë kushte pastërtie maksimale, si dhe kushte specifike pune për kryerjen e tyre. Edhe ky projekt është llogaritur në vlerën rreth 40 milionë lekë.

Projekti i tretë, po për arkivin, janë pajisjet skaner dhe pajisje të tjera për procesin e digjitalizimit të arkivës. Procesi i digjitalizimit të arkivës do të jetë një proces që do të vazhdojë shumë vite dhe do të kërkojë shumë para. Ne mendojmë se ky proces do të vazhdojë 10 vjet me radhë, që të bëhet skanimi, indeksimi, zbardhja, pastrimi i gjërave e të tjera. Ky proces kërkon një investim prej 100 milionë lekësh për investime, blerje skanerësh, pajisje pastrimi, solucione e të tjera dhe pastaj kërkon 100 milionë lekë çdo vit për një periudhë 10-vjeçare për kostot e digjitalizimit, që do të vazhdojë i pandërprerë vit pas viti.

Radiotelevizioni Shqiptar kërkon një shtesë financimi për katër programet që përmenda për vitin 2019 në vlerën totale prej 540 milionë lekësh, sipas materialeve që ju kemi dërguar përpara. Ne nuk mund ta lëmë situatën në Radiotelevizionin Shqiptar në mëshirë të fatit. Në qoftë se nuk do të kemi financimin e duhur, Radiotelevizioni Shqiptar do ta ketë të pamundur të shlyejë këstin e kredisë, që është marrë për procesin e digjitalizimit në vlerën e

400 milionë lekëve dhe që është një kredi e marrë me garancinë shtetërore, që këta zotërinjtë janë të detyruar ta paguajnë. Kaq kisha.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit!

A keni ndonjë pyetje të nderuar kolegë, para se të kalojmë te Qendra Kombëtare?

Urdhëroni!

Bujar Çela – Faleminderit, zoti Gëllçi!

Ne po diskutojmë për projektbuxhetin e vitit 2019, por për hir të së vërtetës, nga e gjithë fjala juaj, unë u mundova të shënoj dhe shikoj se janë pothuajse të njëjtat fjalë, të njëjtat halle që keni thënë edhe një vit më parë, janë po ato halle për të cilat ju kemi thirrur për dëgjuesë, që po i përmbledh: paga orkestrës, rikonstruksioni, teknologjia, kaq lekë atje dhe kaq matanë, arkiva, kredia, ku nuk ka lëvizur asgjë. Kam një pyetje të thjeshtë, pa memorien e këtij kombi, që është arkiva e Radiotelevizionit, ne nuk dihet se ku do të shkojmë. Ne flasim për muze, por muzeu i gjallë, më i madh i këtyre viteve, që ka futur teknologjia është arkiva e Radiotelevizionit. Kërkesat tuaja në pagë, në shifra, janë të reja apo të vjetra?

Thoma Gëllçi – Janë të reja.

Bujar Çela – Atëherë është edhe më alarmante. Unë i propozoj komisionit që t'ju mbështesim, të ngremë zërin për atë zë që kemi, sepse alarmi juaj është standard, i njëjtë dhe nuk lëviz asnjë presje. Kërkesat tuaja unë i shoh shumë serioze dhe nuk besoj se janë kërkesa personale, sepse këtu ikin edhe njerëzit, korrespondentët, të cilët kanë shkuar në televizione private për arsye të pagës, të kushteve të tjera. Nuk e di se çfarë do të bëhet, por sinjalisht kërkoj mbështetjen e komisionit, që ne ta ngremë zërin më fort pranë Ministrisë së Financave, që Radiotelevizioni dhe i gjithë ky aset duhet mbështetur sa nuk është vonë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Urdhëroni!

Fidel Ylli – Ne çdo vit këtë avaz kemi, vijnë kërkesa nga institucionet që varen nga ky komision, relatojnë, ne gjithmonë kemi dëshirë, por më duket se jemi përsëri në vend. Mendoj se është një moment shumë deciziv këtë radhë, sepse ne edhe me vizitën që bëmë, me ftesë të drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit dhe kryetarit të bordit ekzekutiv, e pamë vetë gjendjen reale të Radiotelevizionit Shqiptar. Unë bashkohem me mendimin e zotit Çela dhe të gjithë si komision ne duhet të bëjmë presion pranë qeverisë dhe pranë ministrit të Financave, që këtë institucion nuk duhet ta shikojë si thellë për mish, por kjo është memoria kombëtare. Arkiva aty ishte në gjendje mjerane dhe në qoftë se ne do të zhdukim atë, atëherë do të zhduket një pasuri që ka vlerë të jashtëzakonshme. Mendoj se bashkë me Milvën dhe

Musain, që ka qenë gjithmonë relator i Radiotelevizionit për të gjitha problematikat dhe për ligjin, ne duhet ta ngremë zërin fuqishëm që këto të drejta, që ju i ngritët këtu në komision, kësaj here t'i bëjmë realitet, pavarësisht vështirësive, buxhetet gjithmonë kanë vështirësitë e tyre, por unë mendoj se duhet të kemi një rezultat të rrallë për sa u përket të gjitha kërkesave që ngritën drejtuesit e RTSH-së.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Nisur nga sqarimet që na bëri zoti drejtor dhe duke marrë shkas nga ajo që ne nuk ishim thjesht vizitorë në RTSH, por i pamë gjërat konkrete, sidomos në fushën e investimeve të reja që janë futur. Këtë gjë e shohim edhe te shumëllojshmëria e programeve të RTSH-së, e cila ka një përjasje tjetër në marrëdhënie me publikun dhe me interesin, sepse nuk ka vetëm programe alternative. Vetëm për shkak të ndryshimit nga transmetimi numerik në transmetimin digjital, që u bllokua, pati një reagim të madh publik. Kjo do të thotë se media jo vetëm është pushtet i katërt, por është edhe një ushqim shpirtëror për publikun.

Duke parë atë që është paraqitur në material, vërej me keqardhje se, duke e krahasuar me vitin 2018, ky buxhet është 24,4% më i vogël. Kjo nuk shkon në të njëjtin sens që kanë shkuar të gjitha reformat e kësaj qeverisje në vite. Uroj të jetë një lapsus, por, në qoftë se për vitin 2018 financimi nga buxheti ka qenë 765 milionë lekë të parashikuara, tani është 615 milionë lekë. Kërkesa, me të drejtë, është plotësisht e argumentuar, sidomos në fushën e përfundimit të plotë të projektit për digjitalizimin e të gjithë teknikës së transmetimit, sidomos për digjitalizimin e plotë të gjithë memories historike të më shumë se 50-60 viteve. Ne, si komision, dhe mua më vjen mirë, kemi të njëjtin mendim: duhet ta bashkojmë zërin. Në qoftë se njerëzit rrinë edhe një vakt pa u ushqyer, por pa ushqimin shpirtëror nuk rrinë as një minutë. Sinqerisht, unë nuk e di se si është planifikuar dhe si e kanë marrë institucionet që kanë bërë projektin për këtë punë, por nuk reflektohen aspak kërkesat e institucionit për mbështetje buxhetore. Sigurisht, besoj se këta i kanë bërë në kohë. Por që të kërkojë një shtesë gati 550 milionë lekë, ose e përkthyer në përqindje mbi 85%, sinqerisht nuk e mendoja kurrë që një projektbuxhet do të vinte në këta terma. Ndaj, unë si deputet solidarizohem me kërkesat tuaja dhe së bashku me komisionin do të jemi në një zë për ta mbështetur. Ne e pamë me sytë tanë procesin që ishte në mes, pra të mos e çosh atë deri në fund?! Më mirë mos e fillo një investim, sesa ta lësh peng të investimeve ose halleve të tjera që ka Shqipëria.

Ju faleminderit!

Adelina Rista – Kjo dëgjese na krijoi një ndjeshmëri dhe na ka prekur të gjithëve thellë, për arsye se kemi dëgjuar gjithmonë në prag të miratimit të buxhetit të çdo fundviti kërkesat nga institucionet dhe përpiqemi të krijojmë përfytyrime, por kur i prek nga afër, e

shikon nga afër se si punohet, kushtet dhe vështirësitë që hasen e të gjitha me radhë, krijon perceptime, të cilat të ndihmojnë fort për të reflektuar ndjeshëm, që të bëhemi një zë për një qëllim të përbashkët. U bënë disa vite që unë e dëgjoj RTSH-në në këtë komision dhe, siç e thanë edhe kolegët, thotë të njëjtat kërkesa për gjërat më minimale, pra për të krijuar kushtet e një pune që të arrijnë në standardin që të kërkon koha. Në kohën kur gama e veprimtarisë së RTSH-së është zgjeruar, kur nuk ka radio vetëm me valë të shkurtra, kur ka kanale televizive që kërkojnë shumë më tepër, kërkojnë më shumë teknologji dhe gjithë atë infrastrukturë mbështetëse në burime njerëzore të kualifikuara, qoftë në teknologjinë e kohës, ne ta lëmë TVSH-në në këtë fare feje! E pamë me sytë tanë. Vizita dhe dëgjesa që bëmë në RTSH na ndihmoi për të parë me sytë tanë se si punojnë të gjithë ata që janë atje me ju, si staf drejtues në krye. Të kërkojsh teknologjinë e re dhe të mos përgjigjesh me buxhet, nuk e di! Ta lësh atë arkiv në atë farë feje, që është memoria e këtij vendi në kaq vite, nuk e di se çfarë argumenti mund të jepet që buxheti i televizionit vjen me ulje dhe kur kërkohet më tepër se 50% e buxhetit të miratuar. Besoj se këto kërkesa janë paraqitur nga televizioni. Nuk e di nëse janë paraqitur, më ndihmoni për këtë. Pra, nuk e di se cili është argumenti.

Kolegë deputetë, mendoj se ne duhet të qëndrojmë fort te RTSH-ja. E njëjta gjë u tha edhe vjet. Të njëjtat pyetje kemi bërë. Sot nuk kemi pyetje. Duhet t'i qëndrojmë të gjithë në krah dhe të jemi mbështetës, sepse nuk kemi pse të pyesim. I kemi të qarta gjërat. Duhet të gjithë bashkë të jemi njëzëri që fondet e RTSH-së të shtohen, me qëllim që këtyre zotërinjve, që kanë marrë përsipër ta nxjerrin RTSH-në nga atje ku është dhe ta ngjisin në standardin që kërkon koha, t'u japim mundësinë të punojnë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Përpara se t'ia jap fjalën Musait, dua të bëj disa pyetje. Ne këtu në komision, meqë kemi bërë vizitë në RTSH, i dimë disa gjëra. Ju keni pasur një buxhet, të miratuar në buxhetin e vitit 2018, prej 665 milionë lekësh. Ndërkohë, me një akt normativ, në mes të vitit, buxheti u rrit me 100 milionë lekë dhe keni shkuar në një buxhet prej 765 milionë lekësh. Kur erdhi momenti i negocimit, kanë ndodhur disa gjëra. Ju keni shtuar programin, keni filluar digjitalizimin. Ne e pamë me sytë tanë se sa proces i madh ishte. Ndërkohë, këtë e bëtë me burimet ekzistuese. **Por nuk kuptoj pse nuk i keni marrë në negociatë 665-ën, atë që kishit para aktit normativ? Pse ju është ulur ky projektbuxhet? Cilët indikatorë performance ju kanë çuar në një buxhet më të ulët se ai që kishit parashikuar në vitin 2018?**

Në lidhje me shtesën që ju kërkon, pra kaq shumë, pavarësisht nga qëndrimi i komisionit, sepse ne do të bëjmë presionin tonë, por na duhen argumente për të, a e keni ju kapacitetin human, burimet e mjaftueshme njerëzore për të bërë gjithë këto gjëra, sepse nga ju

kemi dëgjuar mungesën e burimeve njerëzore për të mbaruar disa nga proceset? Kemi parë që disa procese ishin përqendruar në pak njerëz, sepse nuk kishte mundësi të punonin të gjithë. A ka ndonjë lidhje midis indikatorëve të performancës dhe buxhetit më të ulët se viti i kaluar? Fakti që RTSH-ja është një aset publik dhe ne po hyjmë në një erë të re të digjitalizimit, është e padiskutueshme. Çfarë ka ndodhur që nuk keni marrë të njëjtin buxhet?

Mbase këto kërkesa vijnë ngaqë ju keni parë performanca fantastike të televizioneve publike, pra për shkak se jeni duke bashkëpunuar me disa televizione europiane edhe në kuadër të projektit të BE-së. Mos vallë edhe mendimi juaj për një televizion publik fantastik ju çon në këta parametra, pa vendosur shtyllat, sepse është shumë e lartë vlera e buxhetit që kërkon? Është shumë i madh buxheti që kërkon! Është gati 90% më shumë. Pra, është shumë më shumë. Kështu, a mund të kemi një përgjigje për këtë, nisur edhe nga dashamirësia që ka komisioni, sepse ju e patë që komisioni është shumë dashamirës?

Thoma Gëllçi – Së pari, këto nuk shprehin nevojat, sepse nevojat janë për shumë më tepër. Ministria e Financave i ka përcaktuar këto pa u mbështetur mbi ndonjë gjë, sepse ne bëjmë kërkesa, kurse ajo vazhdon të lërë të njëjtat shifra çdo vit. Unë po ju them se shtesat që janë bërë çdo vit nuk kanë shërbyer për asgjë tjetër veçse për faktin se ne paguajmë 3,5 milionë euro këstin e kredisë dhe 2,2 milionë euro kontratën e shërbimeve, pra kaq janë ato, ikin. Nuk ka ndonjë gjë të madhe këtu për të ruajtur, sepse janë këste bankare që paguhen, kur ligji e ka të qartë që transformimin teknologjik të RTSH-së e ka përgjegjësi buxheti i shtetit. Nuk është financuar asnjë projekt tjetër me këto, por janë paguar këste kredie.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këstet dhe shtesat i kemi paguar vetë. Çdo vit jepen 200 milionë jepet për mirëmbajtjen e SLA-së, kur në fakt është 2,2 milionë euro. Për orkestrën simfonike pse paguajnë 60 milionë lekë, kur rrogat janë 70 milionë lekë? Kush do t'i paguajë këto 10 milionë lekë? I ka për t'i paguar përsëri RTSH-ja. Në qoftë se ne kërkojmë një shtesë prej 40 milionë lekësh për transmetimet, ato janë pagesa për satelitin. Janë pagesa satelitore, të cilat ne ua marrim qytetarëve nga taksat dhe, në vend që të bëjmë filma, seriale apo koncerte, paguajmë satelitin që të transmetojmë për bashkatdhetarët. Këto janë detyrime të cilat ligji ia ngarkon buxhetit të shtetit t'i realizojë. Do buxheti i shtetit, qeveria, që ne t'i mbyllim transmetimet satelitore, transmetimet për shqiptarët jashtë atdheut, transmetimet për minoritetet? Ligji për diasporën thoshte se të gjitha shpenzimet për transmetimet televizive për emisione për diasporën përballohen nga buxheti i shtetit. Duan të bëjnë ndonjë emision apo do të transmetojmë vetëm në satelit? Mirë emisione që nuk po bëjmë, as edukative, sepse duan para të bëhen emisionet, por duhen paguar pedagoget, ata që do të bëjnë ABC-në për diasporën. Ne

kërkojmë minimalen e minimales. Ne kërkojmë që këto mjete që transmetohen të jenë. Nuk ka ndonjë marifet për ruajtjen e këtyre fondeve. Çfarë kërkojmë ne?! Kërkojmë 40 milionë lekë të rregullojmë arkivin, të vëmë kondicionerët. Nuk mbaron procesi i arkivit me këta 40 milionë lekë.

Milva Ekonomi – Në këtë kuadër, po ju bëj edhe një pyetje tjetër. Një gjë tjetër që e kemi kaluar edhe këtu në komision për diskutim ka qenë problemi i të ardhurave. Ju punoni me një bilanc që ka të ardhura nga disa burime. Keni të ardhura që vijnë nga *fee*-ja, nga ajo që paguajnë të gjithë familjarët dhe bizneset, keni të ardhura nga buxheti i shtetit, nga donatorët dhe nga sponsorizimet, në qoftë se nuk e kam gabim strukturën tuaj të të ardhurave. Një nga gjërat që ka ndodhur është se në këto vite, falë reformave në fusha të tjera, në këtë rast po flas për energjinë, sepse energjia ka lidhje me ju, është se tarifa familjare, tarifa e bizneseve për RTSH-në është grumbulluar më shumë. Ne paguajmë faturat dhe ajo është grumbulluar. Ju keni një marrëdhënie me OSHE-në lidhur me *fee*-në që mban OSHE-ja për të drejtën e tarifimit që ju bën juve. Ky është një burim në rritje i të ardhurave. Ne tashmë e dimë këtë gjë nga informacionet e tjera. Unë nuk e di sa ka ndryshuar në buxhetin tuaj kjo e ardhur. Buxheti i shtetit edhe vjet ju ka dhënë shtesë me buxhetin faktik. Unë nuk e di sa donacione keni, por të paktën nga takimi kemi parë që keni tri donacione kryesore. Keni BE-në me një projekt asistence teknike; keni OSBE-në që ju bën trajnime, keni edhe Koperacionin Zviceran që ju mundëson disa gjëra për burimet njerëzore, por jo para direkte. Domethënë, zhvisheni nga shpenzimet për trajnime, sepse jua sjellin të tjerët. Keni edhe sponsorizimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Te skema e bilancit të shpenzimeve janë këto. Të ardhurat në vite ju janë rritur pak. Prandaj negociatat me Ministrinë e Financave, përpara se të vinit këtu, janë të rëndësishme. Si jua vë Ministria e Financave tavanet buxhetore? Ka nja tavan buxhetor për shpenzimet rrjedhëse, ku thuhet: fito sa të duash, por do të harxhosh vetëm 120 lekë, pra edhe nëse fiton 150 lekë, do të harxhosh vetëm 120, të tjerat janë të miat. Kush negocion që kjo gjë të jetë në favorin tuaj, se janë rritur gjërat? Ky është fakti. Janë rritur të gjitha të ardhurat që marrin nga burimet e tjera. Kush negocion te ju? Mos është ky një element që e ka detyruar buxhetin të shkojë në këto nivele financimi për ju? Unë nuk e di, por po ju pyes ju, përpara se t'ju japim mbështetjen, siç jua dhamë edhe vjet mbështetjen tonë në Komisionin e Ekonomisë. Kështu që duam të kuptojmë këtë gjë.

Thoma Gëllçi – E ardhura kryesore që financon veprimtarinë e RTSH-së është tarifa mbi përdorimin e aparatit televiziv që mblidhet nga OSHEE-ja dhe i kalon direkt RTSH-së. Kjo parashikohet në buxhet në fillim të vitit me një shumë të caktuar dhe asnjëherë nuk

realizohet sipas parashikimeve. Është e vërtetë që është rritur, sepse më parë ka qenë shumë keq, sepse nuk paguheshin dritat dhe jo më të paguhej tarifa. Gjithsesi, u rrit në një moment të caktuar dhe ka ardhur në ulje në vitet 2017, 2018. Ka qenë në ulje, sepse ne planifikojmë sikur do të mblidhet e gjitha, por ajo nuk mblidhet e gjitha. Këtë vit na janë shkaktuar 100 e ca milionë lekë deficit nga e ardhura e tarifës. Herë pas herë kemi thënë që nga kjo tarifë e grumbulluar, 10% i mban si komision OSHEE-ja. Kjo gjë, siç e kemi thënë herë pas herë, është absurde, sepse është komisioni më absurd dhe më i madh që mund të mbahet për këtë gjë.

RTSH-ja ka ngritur një grup me në krye bordin e administrimit dhe disa njerëz të tjerë që punojnë në RTSH, të cilët po bëjnë planin e biznesit në lidhje me strategjinë e zhvillimit të RTSH-së. Synimi i planit të biznesit është shkëputja nga buxheti i shtetit. Shkëputja nga buxheti i shtetit nuk bëhet duke i kërkuar në Ministrinë e Financave vazhdimisht për të financuar operacionet tona. Ne i kërkojmë Ministrisë së Financave të financojë ato që ka detyrime faktike ligjore dhe që janë shpenzime faktike ligjore. Taksën qytetarët nuk e paguajnë për të financuar radion e jashtme apo për të financuar satelitin për bashkatdhetarët, nuk e paguajnë për të financuar orkestrën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm këtu ndahet, sepse kur flasin, qytetarët nuk thonë që paguajnë taksa për policin, për deputetin, por thonë që paguajnë taksë për RTSH-në, pra se çfarë shikojnë në RTSH. “Pse nuk e transmeton këtë ndeshje RTSH-ja, sepse ne paguajmë taksën? Pse nuk bën këtë apo atë RTSH-ja, sepse paguajmë taksën për RTSH-në?” Kanë të drejtë dhe unë nuk do të dal t’u them: shikoni, ju e paguani taksën, por ne me atë taksë kemi ngritur 60 stacione. Ç’i duhet atij sa stacione kemi ngritur ne? Ai do të shikojë ekranin. Unë nuk mund t’i them atij se ne harxhojmë 1 milionë e gjysmë energji elektrike dhe karburant për këto stacione dhe gjysmë milioni për rojet e këtyre stacioneve se mos na i vjedhin. Nuk i duhet qytetari kjo gjë. Qytetari kërkon programe nga RTSH-ja, pra kërkon që ajo të kryejë misionin që ka: informim, edukim, argëtim. Sigurisht që janë gjëra të mëdha. Edhe tarifa e përdorimit të aparatit është shumë e ulët dhe nuk arrin ta financojë veprimtarinë e RTSH-së. Në qoftë se një qytetar shqiptar për RTSH-në paguan rreth 8 euro në vit për të financuar, në Maqedoni paguhet 36 euro. Në Kosovë po bëhet tani ligji që të paguajnë 2,5 euro në muaj, pra 30 euro në vit që të financohet televizioni. Ne po krahasohemi me Kosovën dhe Maqedoninë, të mos flasim për Slloveninë, që nuk kemi të krahasuar. Nëse RTSH-ja e ka buxhetin 15 milionë euro në vit, ata e kanë 160 milionë euro në vit, të mos flasim për Serbinë dhe vendet e tjera. Në qoftë se ne e kemi seriozisht që duam të bëjmë radiotelevizion publik, ky televizion duhet financuar. Që radiotelevizioni publik të ketë qëndrueshmëri financiare, programore dhe pavarësi, ai duhet të financohet nga taksat, jo nga

buxheti, por kjo prapë nuk e shpëton buxhetin nga detyrimet që janë të përcaktuara në ligj dhe duhet t'i paguajë. Televizioni Shqiptar ka ngelur në atë gjendje, sepse vazhdimisht ka funksionuar vetë për të marrë rrogat. Nëse flasim për rrogat, sepse është krijuar një legjendë e madhe sikur në Televizionin Shqiptar punojnë 2500 veta, por nuk është ashtu, aty punojnë 900 vetë, nga të cilët 100 janë te stacionet lokale, 100 janë nga orkestra simfonike, 150 ose 200 në stacione dhe kemi punonjës më pak se të gjitha televizionet e tjera. A e dini se Report TV-ja ka 130-140 persona, ndërsa njësia e lajmeve në RTSH ka vetëm 80 vetë, shoferë, kameramanë dhe gazetarë të lajmeve? A e dini sa është fondi i pagave në RTSH? Është 30% e buxhetit, ndërsa radiotelevizioni slloven e ka 70% të buxhetit, ndërsa Radiotelevizioni i Kosovës e ka 60% të buxhetit. Rrogat në RTSH nuk janë rritur prej 15 vjetësh dhe nuk është indeksuar as inflacioni dhe janë trima ata që rrinë dhe punojnë aty dhe të themi: “Ne bëjmë sikur i paguajmë, ata bëjnë sikur punojnë”. Nëse e kemi seriozisht që duam ta bëjmë këtë punë, duhet marrë seriozisht se çfarë shpenzimesh duhen për të mbajtur një televizion publik, i cili duhet të realizojë qëllimin për të cilin është ngritur. Nuk mund të vazhdojmë më ashtu sikur ka funksionuar për 27 vjet, që ju bëni sikurse e financoni dhe ne bëjmë sikur punojmë. Nuk do ta mbajmë ashtu!

Musa Ulqini – Unë jam shumë skeptik se mund të bëhet ndonjë gjë, megjithëse fjala juaja, zoti drejtor i Përgjithshëm, ishte shume e nevojshme për të kuptuar të gjithë, nga i pari tek i fundit, se për çfarë po diskutojmë. Ne po diskutojmë sot për detyrimin ligjor që ka buxheti i shtetit për të financuar disa gjëra, që janë përcaktuar shumë qartë në ligj. Ne nuk po diskutojmë për të gjitha të ardhurat e RTSH-së, sepse është një çështje tjetër, por po diskutojmë për detyrimin që ka qeveria. Në të gjithë Europën dhe botën për transmetuesit publikë qeveria dhe shteti kanë detyrimin për të bërë të gjithë investimin, kur bëhet fjalë për ndryshimin e teknologjisë. Këtu ka një keqkuptim shumë të madh dhe unë kam një pyetje, që nuk e kam kuptuar kurrë. Pse kur hartohet buxheti i shtetit, specialistët tuaj, bordi i administrimit, kur ulet përballë zotërisë, i cili është mbrapa dhe përfaqëson Ministrinë e Financave, nuk i shpjegojnë qartë gjërat? Specialistët duhen marrë në RTSH dhe t'i shohin gjërat, sepse kolegët e mi që janë këtu, deri para se të shkonin atje, mendonin se fjalët e mia, që i shprehja me emocion, ishin për shkak të miqësive dhe të njohjeve. Jo, unë nuk flisja me pasion për asnjë arsye tjetër, por vetëm për shkak të asaj që ishte, asaj që duhej dhe se cilat ishin nevojat emergjente dhe sa realizoheshin ato. Sot kolegët e mi folën njëllor siç kam folur unë deri tani. Unë nuk e di se sa mbresa keni lënë te Komisioni i Ekonomisë, i cili është vendimtar, por ju përgëzoj që i ftuat atje dhe besoj se edhe ata vetë u bindën. Kur përfaqësuesit tuaj ulen me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, çfarë debati bëjnë atje?...

Është diçka që nuk e kam kuptuar dhe nuk e kuptoj dot, sepse ne nuk jemi armiq këtu. Kjo çështje aty e ka zanafillën dhe duhet bërë një luftë shumë e madhe. Duhet të mblidhet Këshilli Drejtues dhe t'i ftojë ekspertët që të vijnë, ashtu siç erdhëm ne, dhe të kuptojnë nëse mund të bëhet ose jo, sepse po flasim për teknologjinë nëse bëhet ose jo, ashtu siç nuk bëhet orkestra e RTSH-së me 10 vetë. Ne nuk jemi budallenj. Sot folëm me emocion, sepse i kemi parë konkretisht gjërat që janë duke u bërë dhe nevojat që kanë. Pra, është përtej kësaj shkrese, e cila ka 27 vjet që vjen.

Unë jam shumë skeptik, aq më shumë që Kryeministri na tha që duhet të bindim 3 veta, që unë besoj se duhet të jem gjeni që të bind të tre, për të bërë një ndryshim. Unë shpresoj që kryetari i Komisionit të Ekonomisë, ministri i Financave dhe përfaqësuesi i maxhorancës në grupin tonë parlamentar të kenë *bonsensin* që të kuptojnë se bëhet fjalë për një detyrim, i cili lidhet me revolucionin e madh teknologjik. Unë nuk di ndonjë sektor tjetër, me përjashtim të linjës urbane, ku qytetarët të kenë mundësi të shohin me sy investimin dhe produktin, ashtu siç u investua në Belsh, që duket sikur nuk është i njëjti, po ashtu edhe në RTSH kishim një kanal dhe sot kemi 14 kanale. Ne nuk po kërkojmë për diçka që nuk duket, siç janë sukseset e qeverisë, por është diçka që preket dhe shihet. A mund të na thoni diçka, se ky është i vetmi shqetësim që kam dhe ne kemi fat, sepse këtu kemi një kryetare, e cila ka aftësi menaxhuese, (*mungesë dëgjimi*)... e vetmja gjë që ngelet është shpresa që ne të kemi sukses, por përsëri unë jam skeptik që do të ndodhë diçka e mirë dhe nuk e di se cili duhet të jetë alarmi SOS, që nëse nuk jepen këto shtesa, nuk bëhet gjë! Shpjegimet që thatë në fund janë shumë të nevojshme që t'ua themi të gjithëve, sepse këtu ka legjenda urbane dhe në Shqipëri këto legjenda të marrin në qafë, të cilat kanë marrë në qafë maxhoranca, jo më RTSH-në. Duhet të shikojmë sa është taksa në Shqipëri, në Kosovë dhe Serbi, sa është buxheti në Slloveni, në Kroaci, në Kosovë dhe sa është në Maqedoni dhe, duke i nxjerrë me terma, do të shohim qartë se ku jemi ne dhe se çfarë po kërkojmë.

Thoma Gëllçi – Faleminderit, zoti Ulqini!

Si çdo vit, edhe këtë vit janë bërë bisedime në Ministrinë e Financave, por në ndryshim me vitet e tjera diskutimet janë mbyllur në fazën e parë të projektbuxhetit. Ju lutem, më ndiqini me vëmendje, sepse janë çështje shumë teknike!

Në fazën e dytë, Ministria e Financave dërgon kuotat e financimit buxhetor dhe shprehet se nuk bëhet më asnjë diskutim rreth këtyre shifrave. Pra, është e kotë faza e dytë e hartimit dhe e paraqitjes së projektbuxhetit. Kështu që, në këto rrethana, me gjithë takimet dhe ftesat që ju kemi bërë, marrëdhëniet me Ministrinë e Financave i kemi pasur shumë korrekte, por rezultati ka qenë ky që është edhe sot, që buxheti i RTSH-së për vitin 2019 parashikohet të

jetë 150 milionë më pak lekë financimi nga ai i vitit 2018, ku as në këtë vit nuk është bërë financim i plotë. Kështu që nevojat janë ato që kemi shprehur, të cilat i përmendi edhe drejtori i Përgjithshëm. Çdo muaj ne analizojmë rezultatet, sepse ka pasur edhe probleme të tjera, të cilat vijnë nga vonesat, sidomos nga realizimi i të ardhurave nga OSHE-ja. Këto gjëra janë bërë prezente në të gjitha institucionet shtetërore, në Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Financave, por edhe te ju.

Unë shpresoj që Ministria e Financave, edhe pse jam skeptik si ju, të bëjë një mbështetje më të madhe. Duhet të bëjë detyrimisht ato që duhen bërë sipas ligjit. RTSH-ja nuk kërkon asnjë shtesë financimi buxhetor për kërkesa jashtë ligjit për mediat audiovizive. Kështu që të gjitha kërkesat janë mbështetur mbi ato shpenzime, të cilat janë transparente. Ata mund të vijnë t'i kontrollojnë shpenzimet se sa janë për bashkatdhetarët, sa janë për orkestrën dhe të vendosin. RTSH-ja është e hapur për çdo gjë dhe këtë e kemi shprehur dhe e shprehim gjithmonë.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Ju falënderoj shumë!

Ne jemi angazhuar për t'ju mbështetur dhe, kur të bëjmë relacionin përmbledhës, do t'i marrim në konsideratë të gjitha këto që ju kërkonin në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave.

Ashtu siç ju thashë, kjo nuk është negociatë e lehtë dhe kërkon punë, por neve na duhej të bindeshim për këto gjëra.

Dokumenti që keni sjellë në Kuvend nuk është i njëjtë me atë që keni çuar në Ministrinë e Financave dhe për këtë na duhet informacion shtesë për indikatorët tuaj të performancës. Ju lutem, na i dërgoni edhe neve që t'i kemi në konsideratë për të përgatitur këtë gjë!

Ju urojmë suksese dhe ju falënderojmë shumë për punën që bëni çdo ditë dhe që i keni ndryshuar faqen Radiotelevizionit Shqiptar!

Faleminderit!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës

Sekretar
Fidel Ylli

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Ariana Mero



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.11.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019” me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë (*komision për dhënie mendimi*).

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Ilirian Butka – Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë,

Gentian Opre – drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Ju, si Qendra Kombëtare e Kinematografisë, mund të shtroni kërkesat tuaja në lidhje me këtë projektbuxhet, por besoj se ky diskutim ju bëri mirë edhe juve.

Fatmir Velaj – Para se të fillojmë, dua të falënderoj zotin Butka për suksesin e jashtëzakonshëm që korrën në Poloni në Film Festival të Varshavës, ku delegacioni i filmit me regji të Bujar Alimanit dhe interpretim të Kasem Hoxhës arriti të fitojë festivalin e filmit, i cili është një sukses i jashtëzakonshëm dhe na bën ne ta mbështesim akoma më shumë këtë Qendër.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Bëtë shumë mirë që na e sollët në vëmendje, sepse edhe në Tiranë erdhi jehona dhe u shfaq për publikun para dy netësh.

Ilirian Butka – Dua të theksoj që e vlerësojmë gjithmonë ardhjen para jush, sepse është një nga dyert e pakta që ne mund të trokasim për të qarë hallet tona.

Përpiqem të kuptoj se deri ku është përgjegjësia jonë në mosinformimin qoftë të publikut, qoftë edhe të njerëzve, të cilët kanë në dorë vendimmarrjen për buxhetet e Qendrës dhe gjithmonë ia hedhim fajin vetes duke menduar se nuk kemi bërë aq sa duhet për të promovuar qoftë edhe performancën e mirë të institucionit.

E falënderoj zotin Fatmir për ndërhyrjen, sepse më dha një informacion që lajmi nuk është vetëm yni, por edhe i publikut.

Pa humbur kohë dua të prezantoj para jush atë çka shoqëron këto tri projekte. Jemi paraqitur para Ministrisë së Financave me tri projekte konkrete, sepse ata e kanë përcaktuar që mund të paraqesim jo më shumë se tre projekte, por, në fakt, ne kemi realizuar më shumë se kaq dhe nuk e dimë se ku do t'i gjejmë lekët për të realizuar ato projekte, nëse duam t'i realizojmë.

Megjithatë, po filloj me projektin e parë. Çdo 5 vjet QKK-ja, që nga krijimi i saj prej 20 vjetësh, ka krijuar një ritual të organizimit të festivaleve kombëtare, me qëllim promovimin e atyre filmave dhe atyre produksioneve që ka financuar. Realisht ne e kemi kaluar 5-vjeçarin, jemi në vitin e gjashtë dhe ende nuk kemi mundur të financojmë një festival kombëtar, i cili do të ndihmonte edhe informimin e publik rreth asaj që kemi bërë.

Këtu flitet për një shumë me rreth 13 milionë lekë të rinj, që do të ishin të mjaftueshme për të realizuar qëllimin e madh që kemi. Po t'i referohemi shifrës së filmave, që ne do të prezantonim këtë vit, nëse do ta realizonim festivalin, flitet për rreth 150 filma, që ne kemi financuar gjatë këtyre 4 vjetëve. Pra, në 20 vjet ekzistencë të Qendrës Kombëtare të

Kinematografisë janë financuar gjithsej 313 filma, nga të cilët 150 janë financuar vetëm në këto 4 vjetët e fundit. Pra, po flasim për një hap cilësor për realizimin e filmit në Shqipëri dhe në kualitetin e filmave, sepse rezultatet e frekuentimit të festivaleve ndërkombëtare dhe çmimet e fituara e mbështesin plotësisht këtë që po them.

Nuk po zgjatem shumë në rëndësinë që ka një festival, por po përqendrohen në aktivitetet që do të realizohen brenda suazës së këtij festivali dhe si do të arrijmë ne të përfshijmë publikun dhe një masë të gjerë për të ftuarit e huaj, që duam t'i ftojme në festival.

Kërkesa tjetër për shtesë fondi ka të bëjë me mbështetjen e akademisë “Marubi”, e cila lidhet ngushtësisht me krijimin e një brezi të ri në Shqipëri. Domethënë, nëse ne nuk do të punojmë sot për të ardhmen e brezit të ri, do të kemi probleme serioze në vazhdueshmërinë e kinematografisë shqiptare. I jemi referuar pikërisht kësaj akademie, sepse kjo akademi ka fituar një status të veçantë dhe mbështetje specifike nga qeveria, e cila na e lehtëson punën dhe na krijon premisat për të bashkëpunuar së bashku në koordinimin e aktiviteteve, promovimin dhe krijimin e një brezi të ri, duke shfrytëzuar të gjithë potencialin që kjo akademi ofron.

Shtesa e tretë lidhet ngushtësisht me një projekt, i cili aplikohet për herë të parë nga Shqipëria dhe ka të bëjë me projektin **CIRCE**, i cili është një projekt interes IPA, i financuar nga Europa dhe i përfutur nga tre partnerë të rëndësishëm si: Shqipëria, Italia dhe Mali i Zi. Çfarë parashikon ky projekt?! Me shifrën 180 mijë euro ne parashikojmë të realizojmë një pjesë të projektit tonë, që e kemi kultivuar prej disa vjetësh, për rihapjen e sallave të kinemasë në rrethe. Në Shqipëri ka disa salla nëpër rrethe: në Korçë, në Pogradec, në Sarandë, në Gjirokastrë, në Vlorë dhe në Shkodër. Këto salla kanë nevojë për një investim minimal, që lidhet ngushtë me projeksionet. Projekcioni në pelikul nuk funksionon në asnjë prej këtyre sallave, sepse edhe filmat nuk janë më në version pelikule. Kështu që i gjithë sistemi është spostuar drejt digjitales. Ne kemi marrë një iniciativë që këtë mungesë teknologjike ta realizojmë me fondet europiane dhe për fatin tonë të madh na janë përgjigjur pozitivisht. Dy projektorë digjitalë, me nga 50 mijë euro secili, janë të financuar brenda projektit. Në qoftë se ky projekt funksionon, do të ketë veshë për ta dëgjuar dhe, nëse japim edhe shumën e munguar që kërkohet për t'iu bashkangjitur projektit, ne do të vazhdojmë me digjitalizimin e sallave edhe në Pogradec, Korçë dhe Shkodër. Deri tani kemi lidhur kontratën me qytetin e Gjirokastrës dhe të Vlorës. Besoj se së shpejti do të fillojë të lëvrohet edhe shifra për blerjen e dy aparatave të reja, duke nënkuptuar se do të bëhen investimet e domosdoshme dhe të nevojshme në sallat respektive nga bashkitë.

Gjithashtu, është paraparë realizimi i nëntë serialeve televizive të ideuara nga krijues nën 35 vjeç nga të tria vendet pjesëmarrëse në projekt. Për më tepër, kemi një projekt, i cili

merr përsipër promovimin gjatë gjithë bregdetit Adriatik dhe Puljez të kinemave respektive, është një projekt real që na vjen në ndihmë, duke përfshirë brenda saj disa projekte të tjera të vogla.

Të tria këto projekte që, siç e thashë, nuk janë të vetmet, por janë ato që ne arritëm të përzgjidhnim ndërmjet projekteve tona (mund t'i përmend më vonë projektet e tjera), arrijnë shifrën 27 milionë lekë. Na është përgjigjur Ministria e Financave me një shtesë prej 1 milion lekësh. Kjo do të thotë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk flas për shpenzimet korrente jo, jo! Unë e pata për...

Megjithatë, qoftë edhe pesë.

Tani dua të ndërtoj një dialog. Ajo që tha zoti Ulqini pak më parë është shumë e rëndësishme. Kur ndërtohen buxhetet e institucioneve, ju lutem, na merrni qoftë edhe për konsulencë, në mënyrë që ne të përpiqemi të kontribuojmë për mënyrën si mund të ndërtohet një buxhet.

Ndër të tjera, dua të ndaj me ju një shqetësim, për të cilin nuk kam vërtet përgjigje. Si ndërtohet buxheti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë? Në bazë të cilit kriter? Në të gjithë botën ka dy mënyra për të ndërtuar buxhetin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë: ose kapaciteti prodhues i vendit në industrinë kinematografike, sepse nuk flasim më për NGO dhe as për financime me fonde të humbura, por për industri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qysh kur është krijuar Qendra Kombëtare e Kinematografisë, e cila është krijuar nën kopjen ideale të qendrave të tjera kinematografike të të gjitha vendeve më të zhvilluara, konkretisht kemi marrë esencën e Qendrës Franceze të Filmit dhe është bërë një *copy-paste* duke u përshtatur me kërkesat tona.

Ne flasim për industrinë kombëtare të kinematografisë. Themi se nuk ekziston ose themi se ekziston dhe duhet ta mbështesim, por qëllimi i ndërtimit të një institucioni të tillë është pikërisht ky: të mbështesë kinematografinë e vendit, duke financuar me fonde publike të gjitha nevojat që ato kanë për t'i rimëkëmbur dhe për t'i lëshuar pastaj drejt rrugës së funksionimit normal.

Këtë e kanë bërë edhe shtete të fuqishme, si Franca, që e përmenda, me fonde tepër të larta (diku tek 850 milionë euro është buxheti i Qendrës Kombëtare të Filmit në Francë); 800 e diçka është buxheti i Gjermanisë për filmin (ka disa fonde, por këtu flasim për atë qendrorin), si dhe 450 milionë e ka shtuar tani Italia, nga 80 milionë që ka qenë.

E përsëris, ka dy forma: ose mbështetur mbi potencialin e zhvillimit të industrisë (kapacitetin prodhues), ose mbi numrin e banorëve *per capita*. Kjo është forma minimale referenciale për të vendosur një buxhet kinematografie. Minimalja fare është për kokë, çka nënkupton se, nisur nga sa banorë janë, secili do të paguajë 1 euro, një kafe në vit, për buxhetin e kinematografisë të vendit të tij. Domethënë, ne duhet të kishim minimalisht 3 milionë euro dhe këtu u referohem jo vendeve më të zhvilluara tashmë, që e kanë matur dhe e kanë vlerësuar buxhetin e kinematografisë mbi bazën e potencialit ekonomik, por po u referohem vendeve të rajonit që kemi përreth. Për shembull, Serbia, me 4 milionë banorë, e ka 8 milionë euro buxhetin e kinematografisë, pra 2 euro në vit/banorë; Kroacia, që është vendi më i zhvilluar në rajon për sa i përket kinematografisë, e ka buxhetin 10 milionë euro, i cili, njerëzve largpamës, u është konvertuar automatikisht në 100 milionë euro të ardhura nga promovimi territorial, nga realizimi i disa filmave amerikanë në territorin e tyre. Por kjo është një temë që do ta prekim pak më vonë.

Për të vazhduar me vende të tjera të rajonit, Maqedonia, që ka 2 milionë e diçka banorë, e ka pasur 7 milionë euro; Mali i Zi e ndërtoi tani, për herë të parë, Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, pasi ka qenë nën varësinë e Ministrisë së Kulturës. Nga 600 mijë banorë që janë, e startoi me 1 milion euro; është sa ne. Kosovës, që e kishte 690 mijë euro, iu dyfishua dy muaj më parë nga Ministria e Kulturës automatikisht. Shkuan të kërkonin shtesë buxheti, ia dyfishuan.

Dua të shpjegoj diçka. Ne jemi përballë një konkurrence ndërkombëtare, pra nuk jemi brenda funksionimit si art ose një kategori, ose industri lokale, por jemi përditë në ballafaqim me ta. Nuk është çështje turpi. Pa diskutim që edhe turpi ka të bëjë, edhe mungesa e konsideratës ka të bëjë kur paraqitesh, i tregon se sa e ke buxhetin dhe çdo enti ndërkombëtar i krijon idenë e qartë se sa rëndësi ka kinematografia për shtetin që ti përfaqëson. Kjo të penalizon çdo lidhje kontrate që ti mund të realizosh dhe lidhjet e kontratës për ne janë jetike.

Ne nuk do të kishim sot kinematografi në qoftë se nuk do të kishim të garantuar në çdo film të gjatë bashkëprodhimin me vendet e tjera. Kur flas për bashkëprodhim, nënkuptoj jo të bashkëpunosh, por të financohesh. Për çdo euro që hedh shteti shqiptar ne sigurojmë minimalisht 3 deri në 5 euro të tjera. Domethënë, çdo buxhet yni u bashkëngjitet buxheteve të tjera, që shtetet e tjera vendosin mbi filmin tonë.

Konkretisht, filmi i Bujar Alimanit “Delegacioni” financohet nga Franca me 130 mijë euro; financohet nga Kosova, nga Greqia, financohet nga “Euro Image”, madje edhe nga SE-ja dhe “Creative Europe”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, nëse nuk i përmend të gjithë, pasi është një listë e gjatë! Po të shikoni titrat e filmit, do të shikoni të gjitha logot e enteve publike europiane që e kanë financuar filmin. E gjitha kjo nuk bën gjë tjetër veçse tregon se sa potencial të madh thithës ka kjo lloj industrie përkundrejt të gjitha industrive të tjera, artistike ose jo, në Shqipëri. Pra, në qoftë se ne refuzojmë ta financojmë këtë lloj industrie, ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse refuzojmë të marrim atë fitim që marrim aktualisht nga financimet që të tjerët kryejnë mbi ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa më shumë rritet investimi, aq më shumë do të rritet edhe përfitimi, madje si në çdo industri. Kjo është e paevitueshme.

Dua të lexoj një listë paraprake të financimeve publike (e kam bërë shumë të thjeshtë, ndoshta nuk është shumë e thelluar), që ne kemi përfituar nga entet europiane: nëntë projekte fituese në “Euro Image”, rreth 400 mijë euro, ka fituar Shqipëria; shtatë projekte nga “Creative Europe – Media Program”, 57 mijë euro, flas gjithnjë në euro, sepse me ta vetëm në euro kuptohemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Vazhdojmë. Mbi 20 projekte nga “SE Cinema Network”, 168 mijë euro; projekti “Circe – Interreg – IPA”, të cilin unë e kam paraqitur këtu, është në vlerën 180 mijë euro; shtatë projekte nga Qendra Kinematografike e Kosovës për Qendrën Shqiptare të Filmit, 247 mijë euro; gjashtë projekte nga Agjencia Maqedonase e Filmit, 390 mijë euro; 21 projekte janë bashkëprodhim me Italinë, nga të cilat pesë të financuara nga Ministria e Kulturës në vlerën 500 mijë euro; tre projekte nga Instituti “Luce”, rreth 300 mijë euro; pesë projekte nga “Apulia Film Commission”, rreth 300 mijë euro; e me radhë nga CNC-ja...

Nuk dua t’ju lodh, por, për shembull, Qendra Kroate e Filmit, ajo qendra e zhvilluar, për shembull...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka dhënë 70 mijë euro për filmin shqiptar të Gjergj Xhuvanit.

Domethënë, ka një arsye pse këta financojnë filmat tanë, apo e bëjnë për sadaka? Unë besoj se financojnë filmat e mirë. Qendra Greke e Filmit ka financuar çdo film të mirë tonin. Gjëja e parë që bëjnë kur shkojnë në markete të ndryshme, mund të hapni katalogun e qendrave...

Milva Ekonomi – Po ne, sa filma të huaj kemi financuar?

Ilirian Butka – Edhe ne financojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Falë edhe kontributit tuaj, ne kemi ndërtuar skemën *minority production*, e cila nuk ekzistonte para se të vija në krye të Qendrës. Është një skemë, e cila i përgjigjet pikërisht këtij financimi që ata na bëjnë. Çfarë ndodh? Nga buxheti që ne kemi, një pjesë shkon në favor të këtyre financimeve, filma që në fund quhen tanët. Këta filma nuk quhen filmat e tyre, por kur shkojnë në festival, thonë: edhe filmi shqiptar. Pra, e fitojmë edhe ne çmimin. Mikpritja e tyre i referohet edhe Shqipërisë, jo vetëm vendit të origjinës.

Le të përpiqemi të kuptojmë se pa ngritjen e një dialogu në ndërtimin e buxhetit nuk mund të vendoset apriori që buxheti i Shqipërisë për kinematografinë të jetë patjetër 1 milion euro. Nga cila premisë nisemi?

Ne duhet të kishim minimalisht 1 milion euro të dedikuara për filmin e gjatë, çka nënkupton automatikisht 3 milionë euro të fituara nga fondi ndërkombëtar. Aktualisht, ne përdorim vetëm gjysmën e këtij buxheti për filmin e gjatë, kurse gjysmën tjetër e përdorim për filmin e shkurtër, atë dokumentar, animacionin; për këto projektet që sjellim këtu. Domethënë, pa këto projekte do të vdiste funksionimi i Qendrës dhe do të ishte vetëm një qendër që mbledhet tri herë në vit, bën një financim projektesh dhe kaq. Ama ne nuk kemi këtë funksion, por krijimin e të gjithë suportit të nevojshëm për kinematografinë e këtij vendi. Madje ju garantoj se jemi në rrugë të mbarë. Me 3 milionë euro ne mund të siguronim realisht një lidhësi në rajon.

Ne kemi krijuar prej dy vjetësh *Balkan Film Market*, i cili është totalisht projekt i Qendrës. Të gjitha industritë ballkanike i kthejnë sytë te ne për një javë rresht, Tirana kthehet në elitën e produksioneve më të mira ballkanike. Ata vijnë këtu dhe kontaktojnë, si: SCI-ja franceze, MiBAC-u italian, të gjitha komisionet filmike italiane, dhe i lidhin të gjitha *deal*-et (kontaktet e tyre të punës) mbi këtë bazë. Pra, për herë të parë, ne arritëm të kthejmë vëmendjen e europianëve dhe të ballkanasve, sepse nuk kemi pasur asnjë raport përveç marrëdhënieve të drejtorëve të qendrave kinematografike respektive, që duhet thënë se kanë qenë të shkëlqyera, por nuk ka pasur asnjë lloj financimi ndërmjet njëri-tjetrit.

Ne po përpiqemi ta kthejmë këtë lloj bashkëpunimi në një pasuri, pasi na garanton në disa aspekte, duke aplikuar bashkërisht në projektet europiane. Me hyrjen në “Creative Europe”, tashmë ne jemi *eligible* për të aplikuar në projekte europiane me projekte ballkanike, flas këtu për miliona euro që mund të përfitohen. Por duhet ta vazhdojmë këtë trend, sepse ndryshe do ta humbasim.

Milva Ekonomi – Dua të shtroj dy probleme të mëdha, që i shikoj unë nga diskutimi.

E para, ka një moment emergjence, pikërisht momenti i diskutimit të projektbuxhetit të vitit 2019.

E dyta, duhet të ulemi me Ministrinë e Financave që nga ky çast, pasi nuk besoj se ndryshon qasja ndaj projektbuxhetit. Tani është vonë...

Ilirian Butka – Dakord.

Milva Ekonomi – ...por të paktën për vitin 2020 të fillojë të mendohet një qasje e re për buxhetin tuaj. Ky është hapi i dytë, i cili kërkon tani që ju ose ne, ose Ministrisë së Financave, ose Ministrisë së Kulturës, unë nuk e di se kujt, me kë komunikoni, mos t'i ndaheni lidhur me këtë gjë.

Duhet të ulemi vazhdimisht dhe të themi që buxhetimi për Qendrën do të bëhet mbi bazën e kësaj strukture. Ministria e Financave i ka instrumentet teknike për t'jua mësuar juve se si bëhet planifikimi buxhetor për vitin 2020.

Ilirian Butka – Ne nuk vuajmë nga kjo. Ne ua kemi paraqitur zotërinjve...

Milva Ekonomi – Por, ndërkohë...

Ilirian Butka – Ne i kemi bezdisur me projektet tona.

Milva Ekonomi – E kuptoj, por ndërkohë që i keni bezdisur..

Zoti Butka, unë nuk ju njoh që nga ky moment, por që shumë kohë më parë, por diskutimin për këtë projektbuxhet, siç po e bëni kësaj radhe, nuk e keni bërë vitin e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me kaq pasion keni folur për filmin, por jo për projektbuxhetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e di, sepse kam qenë e ulur këtu.

Ilirian Butka – Genti e di. I kam folur në zyrë me të njëjtin ton dhe mund të jetë çuditur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Unë i mbaj mend gjërat mirë, për të mos thënë...

Ilirian Butka – Është e vërtetë, e vërtetë!

Milva Ekonomi – ...edhe diçka tjetër pastaj. Por unë sugjeroj të diskutojmë për projektbuxhetin e tanishëm. Ju keni 27 milionë lekë që bëni kërkesë për shtim. Vitin e kaluar kemi kaluar një shtesë në ministri prej 8 milionë lekësh për projektin europian. Ndërkohë, këtë vit mund ta bëjmë kërkesën për shumën prej 27 milionë lekësh, por duket që do të ketë edhe prioritet.

Ju keni shënuar tre gjëra, por unë nuk e di se si...

Ilirian Butka – Sepse më thanë që vetëm tre mund të sjellësh, por, në fakt, unë kam gjashtë.

(Iliritet në sallë.)

Milva Ekonomi – Këtu janë tre, ndërkohë për të tria keni vënë nga një numër rendor jo sipas rëndësisë dhe thoni: “Festivali Kombëtar i Filmit, shkolla “Marubi” dhe projekti i Interreg-ut”.

Ilirian Butka – Po.

Milva Ekonomi – Tani, unë do të bëj leximin tim dhe ju pastaj do të më vendosni prioritetet.

Projekti “Interreg”, ku ju merrni një gjë dhe kërkon të bëni digjitalizimin e atyre që janë në *pellicola*, do të shkojë në dy bashki, në Vlorë dhe në Gjirokastrë. A munden këto dy bashki t’ju japin një shans për t’i financuar projektet nga paratë vendore?

Ilirian Butka – Jo.

Milva Ekonomi – Është bërë...

Ilirian Butka – T’jua shpjegoj.

Milva Ekonomi – Të vazhdoj vetëm t’ju bëj pyetjen, në mënyrë që të mos e vëmë këtë projektin në radhë të parë, por në radhë të tretë. Ndërkohë, thoni se për shkollën “Marubi” ka një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave për një strukturë të re, që ka tani dhe ka marrë një status të veçantë, prodhon filma që duhet të dalin me logo, që është QKK-ja e miratuar.

Ilirian Butka – Po.

Milva Ekonomi – Tani, unë ndjek logjikën dhe kam këtu Ministrinë e Financave, që mund të më ndihmojë, dhe juve, sepse ISBN-ja është një *copyright*, që e ka çdo lloj produkti kulturor. Kur unë prodhoj një libër, kushdoqofsha unë, botuesi, kam detyrimin ligjor që pesë kopje t’i çoj te Biblioteka Kombëtare falas.

Ilirian Butka – Po.

Milva Ekonomi – Kur “Marubi” prodhon një film, nuk e ka detyrimin që QKK-në ta vërë aty pa kosto se s’bën?

Ilirian Butka – Jo.

Milva Ekonomi – Nuk e keni parashikuar këtë?

Ilirian Butka – Është prodhimi i tij personal.

Milva Ekonomi – Pse kështu?

Ilirian Butka – Në qoftë se është i financuar personalisht, sigurisht ka të drejtën e tij autoriale mbi produktin. Nuk ka asnjë varësi nga ne, nuk e financojmë ne dhe deri tani nuk e kemi financuar.

Milva Ekonomi – Po pra, po, edhe shtypshkronjën nuk e financon Biblioteka Kombëtare, por e ka kusht ta vërë atë gjë. Në qoftë se “Marubi” do të marrë këtë status të

veçantë, duhet të ketë edhe një detyrë të ngjashme. Domethënë, është një gjë që duhet parë. Unë nuk e di, sepse po e shikoj problemin tani, por është diçka që duhet ta zbulojmë, se nuk di çfarë numri t'i vëmë këtij 7-milionëshit.

Ndërsa Festivali Kombëtar i Filmit, që mua më duket një aktivitet shumë i mirë, unë ndoqa fillimin e Festivalit Kombëtar të Teatrit bashkë me Bujarin dhe me Musain, që ishte një aktivitet që kishte filluar pas shumë vitesh ndërprerjeje...

Ilirian Butka – Vjen pas gjashtë vjetësh ndërprerjeje.

Milva Ekonomi – ...Ndërkohë mua më duket sikur, për shembull, TIFF-i ia doli se u fut në “Oskar”. Në fakt, për atë gjë është edhe merita juaj, zoti Butka, ndaj ju falënderojmë, përveç Varshavës, se keni meritë edhe për atë gjënë tjetër. Dhe TIFF-i është bërë festival referencë, pra kjo për Shqipërinë është vërtet ngjarje e madhe, ku zoti Butka ka meritë personale, që e ka çuar këtë gjë përpara.

Tani, në momentin kur kemi TIFF-in, a merr të njëjtën rëndësi Teatri Kombëtar i Festivaleve? E kam një përgjigje, por është më shumë...

Ilirian Butka – Flisni për festivalin e filmit?

Milva Ekonomi – Po, ndjesë, e pata për Festivalin Kombëtar të Filmit!

Ilirian Butka – Festivali i Filmit do të marrë përsipër vetëm produktet tona, ndërsa TIFF-i i Gonit nuk ka futur shumë filma tanët. Domethënë, është shumë selektiv. Ndoshta ka futur filmat tanë më të mirë, por ne duhet të krijojmë një panoramë të qartë ku është kinematografia shqiptare sot.

Milva Ekonomi – Të filmave që prodhohen në to.

Ilirian Butka – Ky është një udhëkryq shumë i rëndësishëm për të kuptuar në çfarë rruge do të shkojmë qoftë për financimet, qoftë edhe ndaj audiencës, si do t'i përgjigjemi audiencës, si të ndërtojmë një dialog me të.

Ndërtimi i sallave qoftë në Tiranë, qoftë në rrethe ka pikërisht këtë qëllim: të fillojmë dhe të mendojmë strategjinë që ne kemi. Është një nga projektet për të cilat ju fola, pikërisht për ta ndërtuar audiencën që në shkollat e mesme, pra me studentët, duke e trajtuar filmin si gjuhë filmike dhe duke u dhënë atyre çelësin për të kuptuar se çfarë do të thotë film, si zbërthehet një film.

Të gjithë kineastët tanë janë njerëz të lirë në profesion dhe kanë disponibilitetin maksimal të kohës, pra e kanë krejt të lehtë të shkojnë nëpër shkolla dhe të prezantojnë filmat e tyre. T'u shpjegosh atyre se çfarë do të thotë kinematografi, është një praktikë e ndjekur në shumë vende, si: në Francë e të tjera vende, për zhvillimin e audiencës, sepse fillon nga bankat e shkollës dhe pastaj shkohet lehtësisht deri te kinemaja. Ka shumë studentë që nuk kanë qenë

kurrë në kinema. Unë kam parë reagimin e një studenti 20-vjeçar teksa hynte për herë të parë në të, ai u habit dhe tha: “Uau!” Nuk kishte parë... Nuk e kuptonte se çfarë bëhej aty dhe pse hyjnë njerëzit në atë errësirë. Çfarë bëjnë? Ky është hall i madh! Këta njerëz duhet të kalojnë procese të ndryshme, të cilat fillojnë, siç e thashë, që nga shkolla dhe atëherë mund të flasim për një politikë të vërtetë lidhur me kinemanë, për çuarjen e njerëzve në salla e më tej.

Milva Ekonomi – Në rregull.

Ilirian Butka – Përveç këtyre, dua të theksoj edhe një gjë, se të gjithë këtë punë që bëjmë, të gjitha këto projekte, nuk kemi qenë të detyruar t’i bënim. Kjo është domosdoshmëria që ne shohim për të krijuar atë klimë të domosdoshme.

Do të ishte demoralizuese, me thënë të drejtën, në qoftë se nuk do ta shikonim këtë të pasqyruar realisht në një shtesë buxheti në masë progresive, siç ne përpiqemi që në masë progresive të shtojmë projektet, të shtojmë prodhimet, të rrisim edhe rezultatet.

Shtesa që së fundi bëri Ministria e Financave është 1 milion lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ekzaktësisht 10 mijë euro shuma që ka dhënë Qendra e Kinematografisë e Malit të Zi për një nga projektet tona (për Gent Koçin), për të zhvilluar projektin, e theksoj, jo për të bërë filmin. Ky ishte fillimi që Genti të marrë 100 e ca mijë euro në një moment të dytë. Domethënë, njëri nga projektet tona merr 10 mijë euro për zhvillim projekti, që Genti e fitoi në CineLink, në një garë të madhe ndërmjet mijëra projekteve nga e gjithë Europa. Hyn një projekt, që merr 10 000 mijë euro dhe gjithë Qendra Kombëtare e Kinematografisë, me rreth 45 filma të financuar në vit, merr të njëjtën shifër? Unë nuk e kuptoj sa kjo mund të jetë optimiste për këdo që do të vazhdojë të punojë në këtë aspekt apo për të gjithë kineastët. Kini parasysh që janë rreth 1000 njerëz që punojnë në punë sezonale në harkun e vitit në këta filma. Sikur nga 30 vetë për 35 projekte, llogariteni vetë ju sa shkojnë. Ne po përpiqemi të nxjerrim nga ngërçi diçka që ishte tharë. Nëse një peme nuk i hedh ujë, ajo thahet. Ne kemi ngritur një makinë të suksesshme, jam i bindur për këtë, e vlerësuar nga të gjithë partnerët ndërkombëtarë. Kemi punuar shumë mirë dhe nuk e besojmë që kemi vetëm 1 milion euro. Asnjëri nuk e beson këtë gjë.

Milva Ekonomi – Shikojmë pasionin tuaj dhe pa diskutim që e besojmë.

Ilirian Butka – Por është një makinë që tani kërkon benzinë. Unë flas për benzinë minimale. Kërkojmë 1 euro për çdo banor në vit dhe do t’jua kthejmë 10-fish.

Nëse ne marrim një shifër të tillë, unë ju garantoj që nuk do të vij të trokasë më këtu apo në Ministrinë e Financave, për të kërkuar para, nëse ne nuk sjellim çdo vit 10 milionë euro

financime ndërkombëtare vetëm nga skema që po përpiqemi të ngremë, e **Cash Rebayet dhe Task Chapter**.

Kam listën e *e-mail*-ve, që jua kam dërguar, të produksioneve të huaja që duan të realizojnë filmat e tyre në Shqipëri. Është gati e pamundur të kesh gati kërkesën që në momentin e hapjes së një skeme. Përgjithësisht kalon një kohë maturimi, bën skemën dhe pastaj fillon punën për ta promovuar dhe më pas të presësh prurjet. Ne e kemi kërkesën përpara dhe menjëherë fillon puna për të sjellë paratë. Flitet për 1 milionë euro të harxhuara në 35 ditë xhirime.

Milva Ekonomi – Fidel, doje të thoshe diçka?

Fidel Ylli – Unë jam një ndjekës shumë i mirë i filmit dhe kinemasë, ndaj më intereson debati që po bëjmë, por, pavarësisht buxhetit 1 milion apo 3 milionë, që është i ndjeshëm, dua të them shkurtimisht 2-3 gjëra.

Nuk më intereson shumë kjo pjesë, sepse edhe 3 milionë po të japim, nuk do të bëjmë ndonjë gjë të madhe. Mua do të më pëlqente të kishim një bashkëpunim midis pushtetit qendror, pushtetit vendor dhe Qendrës së Filmit për të bërë një eksplorim të kinemave në vend, pasi Tirana është bërë shumë e madhe dhe ka vetëm dy kinema. Pra, të gjithë këta filma që pretendohet të bëhen, qoftë prodhim shqiptar, qoftë i huaj, unë mendoj që duhet të kenë së pari ambientin e shfaqjes, kinemanë.

Për sa u përket filmave të huaj, nga biseda që ne kemi bërë bashkë muajin e kaluar, unë kam bërë një bisedë me Kryeministrin për të gjithë investitorët e huaj që duan të vijnë të prodhojnë filma në Shqipëri. Ndaj, bëni projektin se çfarë taksash duhet t'u ulen atyre, ma sillni mua në komision dhe, me ndihmën e Kryeministrit, do ta kalojmë shumë shpejt, në mënyrë që të gjithë ata aktorë të mëdhenj, që i bëjnë filmat në Kroaci apo Malin e Zi, të kenë mundësi t'i realizojnë filmat këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Silleni ndryshimin dhe do ta kalojmë në ligj. Kryeministri, sa ia shpjegova bisedën që ne bëmë bashkë, tha: “Më sillni projektligjin gati dhe ta miratojmë, që të gjitha kompanitë e mëdha që prodhojnë filma t'i sjellim këtu. T'u ulim taksat dhe, mundësisht, edhe studiot që kanë në Europë, t'i ngrenë këtu. Ne t'u japim tokën, kurse ata të bëjnë investimin këtu për t'i prodhuar”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Këtu ka pasur dy gjëra: investimet e huaja dhe peizazhi artistik.

Peizazhi artistik nuk ekzistonte si koncept në legjislacionin tonë. Te ligji i trashëgimisë kulturore, një nga debatet e mëdha që ne kemi bërë ka qenë për peizazhin artistik.

Po aty kemi marrë përsipër të ndryshojmë që, iu bë pyetje edhe Ministrisë së Kulturës në prezantim, të ardhurat që mbledhin vetë institucionet e trashëgimisë kulturore, sipas ligjit të trashëgimisë, t'u ngelen institucioneve, muzeve e të tjera. Ndërkohë, edhe këtë vit nuk janë bërë gati VKM-të për këtë gjë. Ka një përplasje midis ligjit organik të buxhetit dhe kësaj. Janë të gjitha gjëra që po shkojnë në drejtimin e duhur, sepse të gjithë janë duke menduar si të shtojnë të ardhurat. Patjetër që ne do ta bëjmë këtë që thotë Fideli, sepse e kemi në konsideratë nevojën për financime...*(Mungesë incizimi.)*

Ndërkohë, do të vendosim një listë të prioriteteve të kërkesave që ju keni bërë dhe, kur të mblidhemi për ta dërguar në Komisionin e Ekonomisë renditjen tonë, do të marrim përsipër edhe një mbështetje, siç bëmë edhe vitin e kaluar.

Ismeti do të thotë diçka para se QKK-ja të largohet.

Ismet Beqiri – I nderuar artist, kështu po të drejtohem.

Singerisht na induktove emocion me pasionin që e mbrojtë. Unë uroj që afërt qoftë dita që buxheti juaj të shkojë, pse jo, 10 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju thatë se shuma do të trefishohet. Në qoftë se është kështu, atëherë pse nuk duhet të nxitojmë dhe ta mbështesim të gjithë këtë projekt tuajin?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Afër qoftë, thashë.

Ju sugjeroj, ia kërkoj edhe kryetares së mbledhjes së radhës, që, ashtu sikurse pamë nga afër punën e RTSH-së dhe patëm një qasje tjetër të perceptimit të nevojave dhe kërkesave me gjendjen aktuale që ai institucion kishte, edhe ju të na mirëprisni të vijmë t'ju shikojmë. Singerisht, na ka marrë malli për filmat shqiptarë.

Milva Ekonomi – QKK-ja na ka dërguar dy herë ftesa vitin e kaluar për aktivitete, kështu që duhet të shikojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – E përshëndes kryetarin për shpjegimet që dha dhe pasionin me të cilin foli. M'u duk sikur po fliste për një kohë të filmit që dikur ne të gjithë e quanim "diktaturë". Kinematë kanë qenë tjetër gjë.

Fole për disa shifra të llahtarshme dhe na trembe. Nuk ka asnjë lloj krahasimi me Francën, Puljan e të tjera. Unë kam një sugjerim të thjeshtë, që mundohuni ta bëni. Bëni ndonjë film, qoftë edhe dokumentar, në Ministrinë e Financave dhe gjërat mund të marrin rrugë. Unë marr përsipër që këto materiale t'ia transmetoj edhe kryetares, së cilës ju i jeni drejtuar në material.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Do t’ju gjejmë në ndonjë vizitë në QKK.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër. Faleminderit!

Kolegë, rrini edhe dy minuta sa të vendosim kalendarin për mbledhjen e radhës.

Ministria e Financave, e patë që edhe te ky komision ka debate?

Debate teknike, jo politike.

MBYLLET MBLEDHJA